

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2016

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja.

Me fat!



* A 7 1 8 1 5 *

FAQE E ZBRAZËT

ZINXHIRI SHKAKOR

Nuk është ndonjë urtësi të vërtetohet ekzistenca e korrelacionit të përgjithshëm në mes të raporteve stresuese dhe shëndetit të dobët, dhe të cekën një ose dy drejtime në zinxhirin e mundshëm shkakor. Përkundër hulumtimeve të përkohshme që tregojnë në mekanizmat biologjik, sidoqoftë, skeptikët shpesh pohojnë që në lojë mund të jenë faktorët tjerë krejtësisht të ndryshëm. Për shembull, nëse ndonjë raport i vështirë ndikon në personin që të konsumoj alkool ose duhan të tepruar dhe që të fle më keq, atëherë ata mund të jenë shkaktarët më të shpejtë të përkeqësimit të shëndetit. Prandaj hulumtuesit kanë vazhduar të gjurmojnë drejt bashkimit të caktuar biologjik – bashkimit i cili do të mund të shkëputej qartë nga shkaktarët tjerë.

Ta njohim Sheldon Kohenin (Cohen), psikologun nga Universiteti Karnegi Mellon, i cili me qindra njerëz qëllimisht i ka infektuar me teshtimë. Në kushtet e kujdesit të veçantë, ai sistematikisht i ka ekspozuar vullnetarët në rinovirus i cili shkakton të ftohur të zakonshëm. Përafërsisht te një të tretat e atyre që kanë ardhur në kontakt me virusin është zhvilluar baza e plotë e simptomave, derisa të tjerët këtë ftohje e kanë kaluar me një rrufë të lehtë. Ndërkohë që kushtet e kontrolluara Kohenit i kanë mundësuar që ta vërtetojë përse është kështu.

Metodat e tij janë shumë të ashpra. Vullnetarët e Kohenit njëzet e katër orë para se t'i ekspozohen virusit janë vendosur në karantinë, në mënyrë që të përjashtohet kështu mundësia që të ftohtit ta kenë marrë ndokund tjetër. Pesë ditët në vazhdim (për 800 dollarë) të gjithë vullnetarët kanë qenë bashkë në repartin e veçantë, dhe është dashur që njëri nga tjetri të jenë në distancë të paktën një metër që ta përjashtojnë mundësinë e infektimit në mes veti.

Për këto pesë ditë, në kulturën e tyre të hundës janë kërkuar treguesit formal të rrufës (siç është sasia e përgjithshme e mukozës), si dhe prania e rinovirusëve të caktuar, kurse në mostrat e gjakut është kërkuar prania e antitropave. Kohen kështu i ka mat shenjat e të ftohurit me saktësi më të madhe sesa t'i kishte numëruar ata që kanë fryrë hundët dhe ata që teshtinë.

Është e njohur se niveli i ulët i vitaminave C, pirja e duhanit dhe pagjumësia e rrisin probabilitetin e infektimit. Shtrohet pyetja a munden lidhjet e stresit t'i bashkëngjiten këtij regjistri? Përgjigjja e Kohenit është: nuk ka dyshim se munden.

Koheni u shton vlerat e sakta numerike faktorëve të cilët ndikojnë në atë se një person të ftohet, derisa tjetra mbetet e shëndoshë. Ata që kanë qenë në mes të konflikteve personale për dy herë e gjysmë kanë pas shans më të madh të sëmuren nga rrufa, gjë që marrëdhëniet e trazuara i vendos në të njëjtin rend të shkakut me mungesën e vitaminës C dhe mungesës së gjumit. Konfliktet që zgjasin një muaj ditë, ose më tepër, e kanë rritur ndjeshmërinë, derisa ngatërresat e përkohshme nuk kanë paraqitur asnjë rrezik për shëndetin.

Dhe edhe pse ngatërresat e pandërprera janë të dëmshme për shëndetin izolimi është edhe më i rrezikshëm. Në krahasim me njerëzit të cilët e kanë rrjetin e degëzuar të lidhjeve sociale, ata me numrin më të vogël të marrëdhënieve të afërta kanë pasur 4,2 herë mundësi më të madhe që të sëmuren prej të ftohtit, që vetminë e bën më të rrezikshëm se pirjen e duhanit.

Sa më tepër të shoqërohemi, aq më pak i nënshtrohemi sëmundjes nga rrufa. Duket se ideja është e kundërt me logjikën: a thua se gjasa e ekspozimit të virusit të rrufës nuk rritet sa më tepër që të shihemi me njerëz? Natyrisht. Por lidhjet e thella sociale përforcojnë disponimet e mira dhe i luftojnë ato të këqijat, duke e shtyrë kortizolin dhe duke përmirësuar punën e funksionit imun nën stres. Duket se edhe vetë marrëdhëniet me tjerët na mbrojnë nga rreziku i sëmundjes mu nga ai virus i të ftohurit që na e sjellin ata.

(Danijell Goleman: *Inteligjenca emocionale*, Geopoetika, Beograd, 2005)

1. Shkruaji tre faktorë të njohur që e dobësojnë rezistencën e organizmit nga sëmundja e rrufës.

1 pikë

2. Çfarë është objekt i hulumtimit të Shelldon Kohenit?

1. korrelacioni në mes të marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe gjendjes së përgjithshme të shëndetit,
2. ndikimi i marrëdhënieve shoqërore në rezistencën ndaj sëmundjes nga rrufa,
3. shkalla e ndikimit të stresit në imunitet të organizmit,
4. varësia ndërmjet faktorëve të ndryshëm të rrezikut për shëndetin.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

3. Çfarë ka arritë Kohen me shfrytëzimin e karantinës, me kërkesën që pjesëmarrësit në eksperiment të jenë larg të paktën një metër dhe vërtetimin e pranisë së antitropave?

2 pikë

4. Nga këndvështrimi i numrit dhe cilësisë së marrëdhënieve sociale, të cilat persona janë më të rrezikuara nga rrufa?

1. Personat me numër të shumtë të marrëdhënieve të afërta.
2. Personat që kanë konflikte të përkohshme.
3. Personat që janë të vetmuara.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

5. Sqaroje çfarë është paradoksale në rezultatet e hulumtimit të Kohenit?

1 pikë

Në bazë të tekstit 1 përgjigju në pyetjet 6, 7, 8 dhe 9.

Teksti 1

DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT

Të gjithë personat e shëndetshëm të gjinisë mashkullore dhe femërore të moshës nga 18 deri në 65 vjeç, nëse i plotësojnë kriteret mjekësore pas kontrollimit mjekësor dhe laboratorik mund të dhurojnë gjak. Gjak nuk mund të dhurojnë personat për të cilët mjeku konstaton se vuajnë nga sëmundjet akute ose ndonjë

sëmundje tjetër kronike, ose personat gjaku i të cilëve mund të rrezikojë shëndetin e marrësit të gjakut. Mesatarisht personi i rritur ka 70 ml gjak për kilogram të peshës trupore. Presoni që ka 70 kg ka rreth 5 deri në 5.5 litra gjak. Mund të dhurohet një e trembëdhjeta e pjesës së përgjithshme të gjakut domethënë deri në 450 ml të gjakut.

Pjesa "E lëngshme" e gjakut kompensohet nga rezervat për tridhjetë minuta, kurse elementet qelizore për 30 deri në 60 ditë. Gjatë ditës krijohen 50 ml të gjakut të ri dhe po aq zberthehen. Krijimi i gjakut në palcën ashtërore mund të rritet 6 herë (6x50 ml=300 ml në ditë), çka do të thotë se sasia e dhënë e gjakut, teorikisht mund të përtërihet për një ditë e gjysmë. Më ngadalë kompensohet hekuri që hyn në përbërjen e çdo rruaze të kuqe të gjakut. Prandaj, distanca në mes të dy dhurimeve të gjakut duhet të jetë 3 deri në 4 muaj.

Normalisht, ashtu si edhe para dhurimit të gjakut, e vetmja rregull mjekësore është që pas dhurimit të gjakut të pihet një sasi e mjaftueshme e lëngjeve. Të ushqyerit dhe aktivitetet fizike duhet të jenë të zakonshme. Pas dhënies së gjakut 2 orë nuk duhet pirë duhan, kurse 6 orë nuk duhet punuar pranë aparateve dhe makinerive të rrezikshme dhe të pambrojtura. Gjithashtu rekomandohen personat që në mënyrë profesionale merren me punë në lartësi ose që vozisin , që atë ditë mos të punojnë.

Gjaku jepet nga vena në lakimin e bërrylit ku therja e gjilpërës është më pak e dhimbshme. Në raport me rëndësinë e përgjithshme dhe aktin e dhënies së gjakut, dhimbja është e parëndësishme dhe e çastit. Lidhur me dhënien e gjakut nuk ekzistojnë komplikimet. Niveli i punës së institucioneve të transfuzionit është i tillë që përgatitja e lartë dhe profesionale e kuadrit i garanton dhuruesit të gjakut një siguri maksimale. I tërë materiali për marrjen e gjakut është steril, apirogjen dhe për përdorim të njëhershëm.

Dhurimi i disahershëm i gjakut nuk ndikon në rritjen ose zvogëlimin e peshës trupore, nuk rrit e as nuk e zvogëlon apetitin, nuk zvogëlon dhe nuk rrit aftësinë e punës. Gjaku ruhet në shishet e posaçme ose në qeset plastike në të cilat edhe është marrë. Në qese dhe në shishe gjendet një sasi e caktuar e tretësirës e cila në temperaturën përkatëse (+4°C) mundëson ruajtjen e gjakut nga 21 deri në 35 ditë dhe më gjatë. Në këtë mënyrë mundësohet që "GJAKU E PRET PACIENTIN, DHE JO PACIENTI GJAKUN".

Çdo njësi e gjakut, që do të thotë gjaku i çdo dhuruesit, detyrimisht kontrollohet për: përkatësinë e grupit të gjakut, praninë e antitropave të jashtëzakonshëm (jo të rregullt), shkaktar të sëmundjeve që mund të transmetohen përmes gjakut (sëmundjet ngjitëse) sikurse janë shkaktarët e verdhëzës, AIDS-it (SIDËS) dhe sifilizit.

Disa sëmundje mund të transmetohen edhe përmes gjakut (nga dhuruesi drejt marrësit). Personat që kanë vuajtur nga çfarëdolloj sëmundjeje infektive e kanë për detyrë që t' ia thonë këtë mjekut me rastin e kontrollimit. Personat që janë në dijeni se kanë një rezultat pozitiv në disa sëmundje virusale ose bakteriale (hepatiti, sida ose sifilizi) nuk duhet të paraqiten për dhënin e gjakut. Një rezultat pozitiv në virusin B të verdhëzës në gjak përherë e përjashton një dhurues të gjakut nga dhënia e gjakut. Personat që kanë pasur kontakte heteroseksuale me më shumë partnerë në

një periudhë të shkurtër kohore ose kanë përdorur droga, gjithashtu nuk duhet të paraqiten për dhënie e gjakut. Përkujtojmë që çdo shërbim i transfuzionit teston çdo njësi të gjakut pa marrë parasysh në anamnezën e dhuruesit të gjakut.

(përshtatur dhe marrë nga <http://activelife.awardspace.com>)

Teksti 2

Nëna e Borbardhës është shumë e sëmurë dhe më datën 15 maj është shtruar në spital. Pas të gjitha kontrollimeve është vërtetuar se që për shërimin e saj është i domosdoshëm operacioni urgjent për të cilin duhet të sigurohen sasi të mjaftueshme të gjakut. Operacioni është caktuar për më datën 16 maj, kurse dhuruesit e gjakut duhet t'i lajmërohen Qendrës për Transfuzion më 15 maj nga ora 8 deri në orën 12. Borbardha të gjitha ua tregoi miqve të saj dhe kushërinjve dhe ata i ofruan ndihmë që të jenë dhurues vullnetar të gjakut. Marku, pilot i Montenegro Airlines-it, është djali i tezes së Borbardhës dhe ka 33 vjet. Ai më 15 maj duhet ta drejtojë aeroplanin në relacionin Podgoricë – Cyrih i cili nisët në orën 16 ashtu që ka kohë të mjaftueshme që të jap gjak. Daja i Borbardhës Joni, që ka 45 vjet, është dhurues i rregullt i gjakut. Ai ka dhënë gjak edhe para dy muajsh e gjysmë dhe dëshiron t'i ndihmojë motrës së vet të shërohet. Indriti (22 vjeç) është shok i fëmijërisë së Borbardhës dhe ka marr një ditë të lirë për të dhënë gjak. Është student i vitit të katërt të Fakultetit Ekonomik dhe punon si saldator në një firmë. Shoqja më e mirë e Borbardhës Sonila ka 21 vjet. Ajo para gjashtë vjetësh ka qenë e sëmurë prej verdhëzës dhe Borbardha ka qenë mbështetja e saj e madhe dhe i ka ndihmuar shumë. Tani, në momentet më të vështira për Borbardhën, dëshiron të jetë pranë saj dhe t'i ndihmojë nënës së saj duke i dhuruar gjak.

6. Rrethoje numrin para kohës që mund të kompensohet gjaku i dhënë në organizëm dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Për një ditë e gjysmë.
2. Për 30 deri në 60 ditë.
3. Për 3 deri në 4 muaj.

1 pikë

7. Si duhet sjellë menjëherë pas dhënies së gjakut?

1. Mos të merren lëngje.
2. Mos të pihet duhani 2 orë.
3. Të shtohet marrja e ushqimit.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

8. Përveç temperaturës prej +4°C, çfarë mundëson që gjaku të ruhet një kohë të gjatë?

1. qeset përkatëse plastiket
2. sasia përkatëse e tretësirës
3. shishet përkatëse speciale

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

9. Disa sëmundje mund të transmetohen nëpërmjet gjakut nga dhuruesi tek marrësi ashtu që të gjithë njerëzit nuk mund të japin gjak. A mundet dhuruesi i gjakut që me rastin e dhënies së gjakut të marr sidën ose ndonjë sëmundje tjetër të transmetueshme nëpërmjet gjakut?

PO JO

Rretho PO ose JO dhe shpjegoje përgjigjen.

2 pikë

Në bazë të tekstit 1 dhe tekstit 2 përgjigju në pyetjen 10.

10. A) Rrethoje numrin para emrit të personit që nënës së Borbardhës nuk mund t'i jap gjak.

1. Marku
2. Joni
3. Indriti
4. Sonila

1 pikë

B) Shpjegoje përgjigjen.

2 pikë

11. Cila nga fjalitë e mëposhtme ka strukturën sintaksore të një fjalie të përbërë me lidhje bashkërenditëse?

1. Fuqitë e Mëdha kanë qeshur me to, madje një diplomat bëri një pyetje, pa i mëshuar fort, se a ka një gjë të tillë që quhet kombësi greke, të dalluar nga kisha greke?
2. Gjithë pyetjeve për topografinë ata i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsi të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja për të parë goniometrin tim.
3. Kënaqësia e tij më e madhe është të ngrohet në diell, të pijë duhan, të hajë, të pijë raki, të dremisë ose të vijë rrotull në kopshtin rreth kasolles së vet, duke i rënë lahutës me një melodi të vetme.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

12. Dukej sikur dikush rrokulliste shpella.

A) Tregoje rasën e emrit të nënvizuar (shpella)

1 pikë

B) Në cilën trajtë është përdorur emri i nënvizuar?

1 pikë

13. A) Shkruaji domethëniet e shkurtimeve:

lidh. _____

euf. _____

pj. _____

1 pikë

B) Shkruaji shkurtime të fjalëve:

Bashkimi Evropian _____

e të tjera _____

domethënë _____

1 pikë

14. Janë dhënë termet që tregojnë karakteristikat e caktuara të zhanreve letrare.

Përshkruaji pesë terme që kanë të bëjnë me LIRIKËN.

katërshe, remarke, dukuria, fabula, strofa, kulminacioni, narracioni, subjektiviteti, objektiviteti, këmba, veprimi, akti, novela

LIRIKA:

1 pikë

Lexoji vargjet nga “Komedia Hyjnore (Ferri)” dhe përgjigju në pyetjet 15, 16, 17 dhe 18.

...
E, ja, gati përpjetën pa filluem,
më doli një panterë e lehtë, shpejtë,
që me lëkurë të larme ish mbulueme;

syni mbi mue e mbante ngulun drejtë
e udhën time aq keq e kishte pre,
sa qesh sa herë tue ikë e kthye unë krejt.

Ish koha kur agonte dita e re
e ngrihej Dielli me ata yj në qiell,
që me të ishin, kur Zotynë mni dhe

sëpari i lëvizi n’ ajr të kthiell;
guxim e shpresë në shpirt më kish përtritun
për bish-larushën, që s’po i gjej fill,

...

15. Çfarë ndjenjash mbizotërojnë në strofën e fundit të vargjeve të mësipërme?

1 pikë

16. Si quhet strofa e këtyre vargjeve që përdor Dante?

1 pikë

17. Cila rimë është e përfaqësuar në këto strofa?

1 pikë

18. Simbolika e cilëve numra është përdorur në “Komedinë Hyjnore (Ferri)”?

1. një dhe shtatë
2. pesë dhe tetë
3. tre dhe nëntë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

Në bazë të fjalive të mëposhtme zhvilloji detyrat 19, 20 dhe 21.

1. Një zjarr bubulak përskuqte tërë vatrën, duke përhapur një ngrohtësi për zili mes një zhourime të mbytur...
2. Puna e nderon njeriun. Pse të ardhka keq ty, moj e shkretë. Ata shkojnë të lahen në pishinë çdo të diel. Po ta dija, do të ta thoja. Vafsh e ardhsh shëndoshë!
3. Në kabinet, ngaqë përjashta ishte mjegull, ishte gjysmerrësirë.

19. Cilin funksion sintaksor e kryen fjala e nënvizuar nga fjalia e parë?.

1 pikë

20. Nga fjalitë nën numrin dy përshkruaji pesë forma të foljeve të kohës së tashme.

1 pikë

21. Përshkruaje pjesën e nënrenditur të fjalisë shkakore nga fjalia numër 3.

1 pikë

22. Në fjalinë: *U kthyen kokulur në shtëpi, u është:*

1. Trajtë e shkurtër
2. Trajtë e bashkuar

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve

1 pikë

23. *Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.*

A) Në fjalinë e dhënë gjeje fjalën që nuk është përdorur në gjuhën standarde dhe shkruaje atë ashtu siç duhet.

1 pikë

B) Cilës pjesë të ligjëratës i përket fjala *i përrallshëm* dhe si është formuar ajo?

2 pikë

Lexoje tekstin pastaj zhvilloji detyrat 24, 25, 26 dhe 27.

Në këto e sipër, shtypi i Suedisë nisi të botojë lajme për disa ndryshime që po bëheshin në Shqipëri: Kongresi i Lushnjës dhe ca më vonë Kryengritja e Vlorës, u dukën si shenja jete dhe fuqi morale nga ana e popullit shqiptar. Dr. Gjilpëra i vazhdonte me interes zhvillimet. Kish pasur kurdoherë një ndjenjë kurioziteti për Shqipërinë. Patriot, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk ish. Mendonte si Sokrati, i cili thosh se nuk ish as athenian as grek, po „qytetar i botës”, mendonte si i urti i kohërave moderne, Gëte, i cili refuzoi të marrë pjesë në lëvizjen patriotike të Gjermanisë kundër Napoleonit, se edhe Gëtja e quante veten një „qytetar të botës” si Sokrati. Bota është atdheu i madh i çdo njeriu të kuptuar. Po nga ana tjetër, si mund të ketë përparim, s’mund të zhvillohet njerëzia, po të mos ndahet puna? Si mund të lulëzojë sheshi i atdheut të përbashkët që është bota, në qoftë se njerëzit nuk grupohen në një mënyrë a në një tjetër, për të lë ru ar çdo grup një copë të dheut? Dhe ku ka grupim më pas natyrës se sa grupimi i njerëzve që flasin një gjuhë dhe kanë rrojtur brez pas brezi bashkë në një qoshe të botës? Sokrati dhe Gëtja ishin qytetarë të botës, jo njëri grek dhe tjetri gjerman; megjithatë, Sokrati nuk shkoi në Suze të Persisë ose Memfis të Egjiptit, për të dhënë mësimet e tij, po mbeti në Athinë; Gëtja nuk u vendos në Paris a në Romë për të zhvilluar mendimet e tija, po qëndroi në Weimar. Ashtu edhe kë ta të dy kozmopolitë të lartë kanë pasur njëfarë patriotizma, po në një kuptim të gjerë, fare të ndryshme nga patriotizma e ngushtë dhe urrejtëse e një Demosteni ose e një Bismarku.

24. A) Shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit dhe titullin e veprës nga e cila është shkëputur ky fragment.

1 pikë

B) Me çfarë forme të shprehjes është shkruar fragmenti?

1 pikë

25. A) Si quhet kryepersonazhi i veprës që përmendet edhe në fragment?

1 pikë

B) Cila është ideja kryesore e autorit në këtë pjesë të veçuar?

1 pikë

26. Çfarë e shtynë kryepersonazhin të kthehet në vendlindjen e tij?

1 pikë

27. Kujt dëshiron t'u ngjaj personazhi kryesor dhe cila është arsyeja që i çmon lartë këta njerëz?

2 pikë

28. Rrethoje numrin para veçorive të romantizmit dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Arti është një angazhim i pashmangshëm shoqëror sepse i nxjerr tema nga shoqëria dhe përpiqet që sa më besnikërisht t'i paraqes; është i pranishëm i ashtuquajturit objektiviteti i figurës poetike.
2. Melankolia dhe dhimbja botërore për pavetëdijen e botës dhe njeriut, kultivimi i ndjenjave të përkatësisë kombëtare.
3. Qëllimi është paraqitja e gjërave të cilat nuk mund të përshkruhen në mënyrë racionale, gjegjësisht të stolis me figura ose të përshkruhet një gjë që nuk mund të paraqitet dhe të depërtojë në thelbin e realitetit.

1 pikë

29. Rrethoje numrin para përfaqësuesve të simbolizmit dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Bajroni, Pushkini, Gëte
2. Gogoli, Tolstoji, Turgenjevi
3. Malarme, Rembou, Verleni

1 pikë

30. Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. Takimi i botës së gjallë dhe të vdekur në veprën “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Shkruaj për misionin e gjeneralit dhe priftit.
- Çfarë paraqet figura e priftit dhe gjeneralit bashkë?
- Çfarë paraqet një gjeneral që kërkon eshtra në kohë paqeje?
- Si përshkruhet Shqipëria dhe shqiptarët përmes syve të gjeneralit dhe priftit?
- Si fillon takimi i botës së gjallë me të vdekurën?
- Çfarë paraqet figura e plakës Nicë?
- Çfarë simbolizon varrosja e kolonelit Z. te pragu i derës?
- Si ndodh përballja e gjeneralit dhe kolonelit Z.?
- Kush fiton në fund bota e gjallë apo e vdekur?

2. Si të fitosh gjatë sezonit?

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Jepe mendimin tënd për punësimin sezonal/afatshkurtër të të rinjve në Mal të Zi. Argumentoje qëndrimin tënd.
- Përmendi punët sezonale të cilat kërkohen më së shumti.
- Në bazë të ndonjë shembulli sqaroje dallimin në mes të punëve fizike të vështira dhe të lehta.
- Cilën punë sezonale do të doje ta bësh. Përshkruaje atë punë dhe jepi argumentet me të cilat do ta arsyetosh zgjedhjen tënde.
- Shkruaj për mangësitë dhe të mirat e punës sezonale. Çfarë është qëndrimi i bashkëmoshatarëve tu për punën sezonale/afatshkurtër?
- Disa pohojnë se puna sezonale ofron edhe aftësim profesional, kurse të tjerët që puna sezonale ofron vetëm një përfitim modest ose të mirë. Përcaktoju për njërin prej këtyre pohimeve dhe ceki argumentet me të cilët do ta shpjegosh këtë pohim.

25 pikë

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9